



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Protokoli/Protokol/Protocol Nr.

Lëshuar nga/Puštено od/Released from:	Përgaditur më/Pripremljenodana/Prepared at: 02-07-2026
Për/Za/To : z.Smajl Latifi- Kryetar i Komunës së Rahovecit	
Përmes/Preko/Over:	
Nga/Od/From: Irfan Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim	
Lënda/Predmet/Subject	
Raporti tre mujor i punës, Janar - Qershor	

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-mars 2026, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat sipas planit të punës për vitin 2026. Synimet e drejtorisë për punë efikase, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë, bashkëpunim me akterët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional nga NJPZSH, përmbyllin sukseshëm punën tre mujore të DMSH.

Gjatë periudhës Janar-Qershor sipas planit janë realizuar keto aktivitete:

- Në komunën e Rahovecit në muajin janar, përkatësisht me datë 5, 6 dhe 7 Janar, si pasojë e reshjeve të shumta dhe pa ndërprerje të shiut, janë shkaktuar vërshime në pjesë të ndryshme të komunës së Rahovecit, zonat më të prekura nga vërshimet kanë qenë; Fortesa, Xërxja, Ratkoci, Qifllaku, Malsia e Vogel, Gexhë, Dibidol, Krushë e Madhe etj. Dëmet janë shkaktuar në ekonomitë familjare, Bujqësi, Biznese, infrastrukturën Publik dhe Private.
- Pasë vlersimit të dëmëve dhe përpilimit të Raportëve nga Komisioni për vlersim të dëmëve për vitin 2025 dhe për vërshimet e datave 5,6 dhe 7 janar 2026, të dy raportët, së bashku me lëndët përkatëse janë dorëzuar në komisionin qendror për vlersim dhe kompenzim të dëmëve.
- Sipas planit vjetor të punës janë inspektuar dhe vlersuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në Komunën e Rahovecit, ky inspektim është bërë për të ulur rrezikshmërinë nga Fatkeqësit natyrore përkatësisht për uljen e rrezikut nga vërshimet.
- Pas vlersimit të gjendjes në terren të lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura, është përpiluar raportin me të gjeturat në terren. Raporti u është prcjelle drejtorisë për Sherbime Publike, drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtorisë së Bujqësisë për sanimin/përmisimin e gjendjes në terren, me qëllim të uljes së rrezikut nga vërshimet.

- gjatë kësaj periudhë është kryer servisimi i rregullt i katër automjetëve të Zjarrëfiksëve, po ashtu është bërë riparimi teknik i një automjeti të Zjarrëfiksëve dhe i një pompe të ujit.
- Me datë 07 mars 2026, rrethe ores 1500L është humbur Alush (vesel) Kastrati nga Fshati Zatriq, nga data 08 deri 12.03.2026, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpetim ka qenë e angazhuar në operacionin e kërkimit të përsosur të humbur, në këtë operacion kanë qenë të angazhuar edhe njesia e Zjarrëfiksëve, ekipet mjekësore nga QKMF-së, Policia e Kosovës, FSK si dhe Shoqata e Kërkim Shpëtimit të Kosovës, pas gjetjes së trupit të pajetë me 12 mars 2026, operacioni i kërkimit është përmbyll.
- Më 30 prill është realizuar një ushtrim në tavolinë, me fokus në koordinimin ndërinstitutional dhe identifikimin e kapaciteteve komunale për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Ushtrimi u zhvillua në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ekipin amerikan për Çështje Civile.
- Me 4 Maj është shënuar Dita Ndërkombëtare e Zjarrfikësve me q'rast janë zhvilluar aktivitetet të ndryshme për nder të kësaj dite, Gjithashtu, Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi, ka ndarë mirënjohje për disa zjarrfikës për kontributin dhe angazhimin e tyre.
- Në kuadër të planit të punës, janë organizuar ligjërata në institucionet arsimore dhe janë shpërndarë materiale informuese për ngritjen e vetëdijes së nxënësve lidhur me masat e mbrojtjes dhe parandalimit të hershëm të zjarreve.
- Gjatë muajve maj dhe qershor është ndërmarrë një fushatë vetëdijesimi për mbrojtjen nga zjarret dhe raportimin e tyre gjatë sezonit veror. Janë shpërndarë apele dhe materiale informuese në lokalitete të ndryshme, si dhe janë realizuar aktivitete informuese përmes rrjeteve sociale, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për parandalimin dhe raportimin e rasteve të zjarreve në kohë. Fushata e vetëdijesimit do të vazhdojë edhe gjatë muajve korrik dhe gusht, me synim informimin dhe sensibilizimin e mëtejshëm të qytetarëve për rreziqet nga zjarret dhe rëndësinë e raportimit të tyre në kohë.
- Gjatë muajit qershor, në kuadër të masave për parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet, është realizuar pastrimi i një pjese të shtratit të lumit Bellaja, me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së ujit dhe uljes së rrezikut nga përmbytjet në atë zonë. (Punimet janë realizuar nga operatori ekonomik i kontraktuar nga Drejtoria e Bujqësisë).
- Në muajin qershor, në bashkëpunim me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) me mbështetjen nga OSCE, është mbajtur një punëtori për menaxhimin e fatkeqësive natyrore në Komunën e Rahovecit. Punëtorja është zhvilluar sipas një skenari specifik për menaxhimin e vërshimeve në Komunën e Rahovecit, me fokus forcimin e kapaciteteve institucionale dhe koordinimin ndërinstitutional në rast të emergjencave natyrore.
- Gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe detyra tjera rutimore ditore.

- Ekipi i zjarrfikësve nga Janari deri me 1 Qershor, ka marrë gjithsej 126 kërkesa për intervenime, nga këto kërkesa për intervenime, 47 ishin kërkesa për intervenime në raste zjarri, 8 aksidente rrugore, 11 vërshime, 29 teknike dhe 31 shërbime.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2025														
2026	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknik e	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vershime	Të rejsh m	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
								zj .	qyt .	to t	zj. .	qyt .	to t	
Janar	44	8	21	3	1	11	0	0	0	0	0	0	0	44
Shkurt	12	7	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12
Mars	33	20	4	8	1	0	0	0	0	0	0	0	0	33
Prill	16	8	0	7	1	0	0	0	0	0	0	0	0	16
Maj	21	4	3	9	5	0	0	0	1	1	0	0	0	21
Qershor	18	12	4	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	18
Gjithësej	144	47	29	31	8	11		0	0	0	0	0	0	144

Irfan Berisha
Drejtore i DMSH

